



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE,
I MBAJTUR MË 23.02. 2016**

**SA JAVNE DEBATE KOMISIJE ZA NADGLEDANJE JAVNIH FINANSIJA, ODRZANE
23.02.2016. GODINE**

**SHKURT – FEBRUAR
2016**

KRYETARI: Mendoj të fillojmë punën, sepse edhe kohën e kemi të limituar, që brenda një orë e gjysme eventualisht duhet ta përfundojmë këtë dëgjim publik.

Të nderuar koleg deputet,
Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,
Të nderuar përfaqësues të shoqërisë civile,
Të nderuara media dhe ju të tjerët të pranishëm

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, ka vendosur ti ftojë, të gjitha palët e interesit për të diskutuar, lidhur me Projektligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Ashtu siç jeni në dijeni Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike ka aprovuar në parim këtë projektligj dhe i njëjti ka kaluar në lexim të parë në seancë plenare.

Në ndërkohë Komisioni ka formuar grupin punues për shqyrtimin e Projektligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, për ta shqyrtuar dhe për të përgatitur draftin përfundimtar para leximit të dytë në Komision dhe me pastaj në seancë plenare.

Po ashtu shfrytëzoje rastin të ju njoftoj se për këtë projektligj kemi pranuar komentet nga GIZ-i, Grupi për Studime Juridike dhe Politike, nga Sindikata ZAP-it, nga Drejtoria për Standardizim dhe Përafrim Ligjor e Kuvendit etj.

Komentet mund ti gjeni në materialin e shpërndarë nga Administrata e Komisionit.

Ky projektligj ka për qëllim evitimin e paqartësive dhe mangësive të ligjit aktual dhe po ashtu ky projektligj nxirret për sigurimin e një niveli më të lartë të pavarësisë së Auditorit të Përgjithshëm, konformë praktikave më të mira.

Ka pas komente nga disa individ se ligji nuk ka kuptim të ndryshohet por po ja u përkujtoj që në start se ligji i cili ka qenë deri më tash ai ka qenë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, .. standarde dhe mënyrën e përzgjedhjes së drejtorit të auditorit të përgjithshëm të Zyrës Kombëtare, ndryshe rregullon Kushtetuta, ndryshe rregullon ligji. Ka edhe disa çështje tjera që pretendojnë përmes këtij draftligji do t'i tejkalojmë ato ndryshime.

Projektligji rregullon organizimin, veprimtarinë, dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Po ashtu Projektligj përcakton fushëveprimin për auditimin e jashtëm dhe auditimin e fondeve publike, ekzekutimin e buxhetit, përdorimin dhe qeverisjen e burimeve publike, rrit nivelin e transparencës në funksionimin e Auditorit të Përgjithshëm.

Me këtë Projektligj do të harmonizohen definicionet e vjetruara me standardet ndërkombëtare etj.

Me qëllim që t'i dëgjojmë, vërejtjet dhe sugjerimet e juaja Komisioni ka organizuar këtë dëgjim publik ku më pastaj gjatë shqyrtimit, miratimit, amendamentimit të tij do të merren parasysh. Me këtë edhe e hapi takimin dhe pres komentet e juaja.

Para se të fillojmë ju lutem çdo njëri që e merr fjalën me që mbledhja incizohet, prezantohuni institucionin dhe vetveten.

Kush e donë fjalën. Paraprakisht po ja japim fjalën propozuesit të draftligjit, me na e bë ndonjë koment në pika shkurtra. Urdhëro! Nëse nuk ke, vazhdojmë drejtë në komente tu i lidh me nene përkatëse. Urdhëro!

Enis Spahiu : Faleminderit, kryesues!

Nuk po kam ndonjë koment të veçantë, vetëm desha ta përkujtoj që edhe ne si organ propozues kemi zhvilluar konsultimet paraprake dhe publike dhe për ... e Komisionit të gjitha ato komente që i kemi pranua i kemi vlerësua dhe janë të kompletuara shumë mirë në aneksin e memorandumit shpjegues, këtë mundeni me e pa edhe aty ... si i kemi vlerësua ne komentet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe juve! Kush e donë fjalën. Urdhëroni!

Dren Ajeti: të nderuar anëtarë të Komisionit,

Të nderuar të pranishëm,

Grupi për studime juridike po ashtu ka përcjell Projektligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe i ka pasur disa propozime dhe disa vërejtje të cilat janë në ligj.

Janë gjithsej propozime të cilët ... secilit nene ose secilit propozim që ... mirëpo mundeni në këtë mënyrë të përgjithshme ose përgjithshishtë t'i rregullojmë pak a shumë pikat tona të cilët ... që të përfshiheshin ...

Fillimisht është neni 1, do të thotë i qëllimit të cilit duke i pa vendet e tjera dhe bë krahasime në zyra të tjera të auditorit apo ... në fjalë e kemi bë një propozim tjetër që ka me rëndësi do të thotë të shihet se fusha ... duke përcaktuar saktë punën e subjektit të cilët auditohen ... buxhetit e të tjerë.

Kështu që kemi propozua që neni 1, të definohet kështu. “Me këtë ligj rregullohet kontrolli dhe auditimi i shpenzimeve për fondet publike, auditimi i të gjithë njësive qeveritare qendrore edhe lokale si dhe të të gjithë njësive administrative duke përfshirë të gjithë subjektit të cilët financohen pjesërisht apo plotësisht me buxhetin e shtetit, ndërmarrjet publike, të gjitha kompanitë në pronësi të Republikës së Kosovës si dhe Bankës Qendrore.

Neni 1, do të thotë i projektligjit në fjalë është shumë i përgjithshëm dhe shumë pak do të thotë e përbën qëndrimin e këtij buxheti. Ne mendojmë se përfshirja e këtij neni ose ndryshimi i këtij neni do të qartëson lexuesit shumë më lehtë se për çka do të thotë kjo.

Po ashtu i kem edhe propozim në nenin 2, te fushë veprimtaria që mendohet dhe thotë se është me rëndësi që .. në mënyrë të detajuar ... siç është veprimtaria e buxhetit.

Me qëllim që të përcaktohet gjithë aspekti e kontrollit të auditimit.

Nuk po di tashme hy nen për nen me i lexua propozimet tona, ndoshta do të zgjas shumë, kështu që më mirë po futna përgjithësisht.

KRYETARI: Komentet i keni me shkrim, Urdhëroni veç ato që mendoni.

Po, kush do që është i interesuar mund t'ia dërgojmë lirisht.

Kemi edhe disa ndryshime tjera do të thotë te neni 3, mendojmë që duhet të fshihet shprehja gjegjësisht, shpenzimi i parasë publike, autoritet publik dhe auditor shtetërorë për shkak që vazhdimisht përmendet në projektligj, kurse nuk është përfshirë nëpër përkufizime te neni.

Po ashtu mendojmë që duhet të bëhet ri strukturim i neni 4, me qëllim që të arrihet një ... apo një strukturim ... i ke përmendur thotë që pika 4 të bëhet pika 1, pika 5, pika 2, pika 6, pika 3 e kështu me radhë ...

E rëndësishme është që pika 6, ose paragrafi 6 i neni 4 të riformulohet si në vijim duke i shtua disa pika të reja.

Auditori i përgjithshëm duhet të jetë, shtetasi i Republikës së Kosovës të ketë diplomën universitare dhe përvojën e duhur në kontabilitet dhe auditim, financa publike ose administratë publike periudhë ... 10 vite nga të cilët 5 vite në punën menaxheriale të jetë auditor i licencuar e mos të jetë subjekt i ... të jetë i paanshëm, të reflektoj shkallën më të lartë të standardeve, të mos e kalon moshën 60 vjeçare.

Mendojmë që do të ishte mirë që fillimisht në projektligj të ceken të gjitha pushtetet të cilat do t'i plotësoj auditori i përgjithshëm pasi janë paka shumë të shpërndara në disa nene.

Mendojmë që do të ishte mirë që kjo të regjistrohet në një paragraf ..

Po ashtu mendojmë që pika 7 e këtij neni, po ashtu do të thotë të ristrukturohet dhe të formulohet si vijon: “Pozita e auditorit i përgjithshëm është punë me orar të plotë, ai gjatë kohës gjersa shërben si auditor i përgjithshëm nuk mund të jetë i punësuar me pagesë ndonjë vend tjetër pune të jetë pjesë e një ministrie të qeverisë lokale, të merr pjesë në aktivitete të partive politike dhe të jetë pjesë e bordit menaxhues dhe mbikëqyrës të një kompanie si dhe lejohet që të angazhohet ... por me kusht që kjo të mos ndikoj në performancën e tij gjatë ushtrimeve të detyrave.

Në pikën 7 të neni 4, paka shumë përmendet... të komentojmë edhe këto që do të ishte e udhës që të bëhet ... i mirëfilltë i neni.

Po i kaloj disa pika për të lidhur te pika 14, mendojmë në nenin 4, do të duhej të shtohet pika 14, një pikë shtesë që merrem me përgjegjësi të auditorit të përgjithshëm.

Pse do të thotë që duhet të ceket një paragraf i ri, me qëllim e thotë të përfshirjes së përgjegjëseve. Kjo do të thotë ka për qëllim që të lehtësojë do të thotë plotësuesi i ligjit të kuptoj qysh në start se cilat do të jenë detyrat e auditorit të përgjithshëm dhe të mos fokusohet në gjithë ligjin për ti kuptuar detyrat.

Kështu që mendojmë se përgjegjësitë e auditorit të përgjithshëm duhet të jenë, të ceket si pikë e 14 të nenit 4. ... të menaxhoj zyrën kombëtare të auditimit, të hartoj propozim buxhetin për Zyrën Kombëtare të Auditimit, të hartoj planin vjetor të auditimit, të vendos lidhur me raportet e auditimit, të hartoj rregullore të brendshme, të raportoj do të thotë te auditimi tek institucionet shtetërore dhe të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike me qenë kohë..., të hartoj rregullat të cilit do t'i përmbahet personeli të gjithë kryesuesit e departamentit dhe të vendos për çështje të tjera sipas ligjit.

Mendojmë që do të ishte e udhësh që të përfshihet edhe një paragraf i tillë që në start përfaqësuesi i ligjit ta dijë cilat janë kompetencat e auditorit të përgjithshëm.

Po i kaloj pra disa pika dhe po futem tek propozimi i ... gjegjësisht neni 6 që është detyra e zyrës Kombëtare të Auditimit. Këtu ... që do të duhej të shkojmë në një dispozitë e re me emërtimin funksionet dhe kompetencat e Zyrës Kombëtare, do të thotë të ishte hartuar si në vijim. Funksionet dhe kompetencat e Zyrës Kombëtare janë, ushtrimi i kontrollit ekonomik.

Gjatë realizimit të auditimit Zyra Kombëtare ka qasje në kontrollin e brendshëm të subjektit të audituar, performancën e menaxhmentit dhe saktësinë e sistemit të teknologjisë.

Kjo për arsye se në projektligj në bazë të specifikimit të funksioneve dhe komenteve që ka Zyra Kombëtare dhe e Auditimit prandaj është me rëndësi që të shtohet edhe kjo pikë.

Po i kaloj edhe disa pika të tjera me qëllim që të mos zgjasë shumë.

Është propozimi i 8, edhe një herë po them , kudo që ka ... edhe mendojmë që në nenin 10 menaxhmenti, pika 5 të ndryshohet si në vijim. Auditori i përgjithshëm dhe zëvendës auditori i përgjithshëm nuk mund të marrin pjesë në ndonjë vendim lidhur me auditimin e institucionit në të cilën kanë qenë anëtar të menaxhmentit gjatë 5 viteve të fundit.

Teksti i projektligjit parasheh një periudhë më të shkurtë sa i përket raportit paraprak të Auditorit të Përgjithshëm dhe të zëvendës auditorit... Periudha do të thotë që është përfshirë ka qenë ... fundit, por mendojmë që do të duhej të zgjatet në 5 vitet e fundit në mënyrë që të krijohen kushte më të favorshme për shmangien apo minimizimin e rasteve të konfliktit të interesit.

Për më tepër 5 vitet e fundit është një periudhë minimale brenda së cilës auditori i përgjithshëm dhe zëvendës-auditori i përgjithshëm është i pranueshëm, e kem pasur një raport të caktuar me subjektet që...

Lidhur me nenin 16, mendojmë që do të duhej të shtohet një pikë e re, apo pika 1, do të thotë pikës 1 dhe pikës 2 dhe të hiqet teksti të auditorit të cilës si pikë e re mendojmë që do të ishte e udhës të bëjë rekrutimin, vlerësimin, ngritjen e detyrës, shkarkimin dhe masat e tjera disiplinore për shërbyesit civilë në Zyrën Kombëtare të Auditimit, kërkohet në përputhje me Ligjin për shërbimin civilë.

Dhe në fund Ligji për shërbimin civilë nuk zbatohet për auditorin e përgjithshëm, zëvendës-auditorin e përgjithshëm dhe ndihmës auditorit e përgjithshëm.

Vetëm po e arsyetoj edhe këtë nenë, po e arsyetoj shpejtë dhe pastaj Visari mund ta elaboroj. Ose le më mirë Visar që ky për komentim ose këto propozime janë bë së bashku prej .. për studime juridike dhe instituti GAP. Faleminderit!

Kryetari: Faleminderit!

Para se të vazhdojmë fjalën, po ju përkujtoj se këtë ligj Komisioni në legjislacion e kaluar e ka pasur si objekt draftimin dhe ndryshimin e tij. Kemi pasur një kontribut të jashtëzakonshëm na ka dhënë edhe Zyra Qendrore e Auditimit.

Dhe, një prej popullatave kryesore të cilat kanë qenë edhe rezultat i asaj që Komisioni ka pasur një qëndrim tjetër, ata kanë mbajtur një qëndrim se auditorët nuk mund t'i përkasin kategorisë së shërbyesve civil por duhet të jenë një statut të njëjtë si gjyqtarë, trajtohen pra me Ligjin e punës.

Prandaj, vërejtja që disa nene këtu që janë dhënë, vijë me atë, është mirë t'i përpunoni dhe bashkërisht në suaza të atyre vërejtjeve popullata kryesore që i ka dhënë janë edhe komentet.

Urdhëroni!

Visar Rushiti: Faleminderit, kryesues!

Përhëndetje për të gjithë anëtarët e Komisionit që janë të pranishëm,
Unë jam Visar, vijë prej Institutit GAP.

Siç e përmendi kolegu, Grupi për Studime Juridike Politike dhe Instituti GAP ka përgatitur një numër të komenteve për të punuar draftligjin dhe i kemi dërguar në Komision.

Unë po vazhdoj me një pjesë me një numër të propozimeve që kryesisht kanë të bëjnë me kapitullin IV, pikërisht lidhem me atë që ju e përmendët.

Ne besojmë se ashtu duhet të jetë, po ky është komenti i juaj, është respektiva që ne e shohim atë, pastaj është e Komisionit se si vendosin ata atë pjesë.

Pikërisht ka të bëjë me nenin 16 tek stafi. Ne mendojmë se pika 1 dhe pika 2 e nenit 16, duhet të formulohet dhe të epet më shumë hapësirë zbatimit të ligjit për shërbimin civilë, e pika 1, të jetë si kështu. "Rekrutimi, vlerësimi, dhe masat janë disiplinor për shërbyesit civil në Zyrën Kombëtare ku bëjnë pjesë auditorët dhe stafi mbështetës, do të bëhet në përputhje me Ligjin për shërbimin civil.

Më duket se ashtu siç është e formular pika 1 dhe 2 i nenit 16, tërthorazi e përmendi Ligjin për shërbimin civil, mirëpo nuk është që duhet të bëhet gjithsesi sipas Ligjit për shërbimin civil.

Te pika 2, për shembull thuhet në fjalinë e fundit, duke e bërë këtë do të merren parasysh vlerat dhe parimet në Ligjin për shërbimin civil. A është e drejtë apo nuk është e drejtë e vlerësoni ju, mirëpo qëndrimi jonë është se duhet të jetë në përputhje apo duhet të jetë gjithsesi e bërë në bazë të Ligjit për shërbimin civil.

Çdo rregullore, çdo doracak, çdo udhëzues tjetër që nxjerret dhe aplikohet në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm duhet të jetë gjegjësisht në harmoni me Ligjin për shërbimin civil., duhet të jetë më obligative.

Pika tjetër ka të bëjë me neni 17, detyrat dhe të drejtat e stafit.

Në përgjithësi mendojmë se preken edhe detyrat e stafit, nëse ato nuk preken edhe diku tjetër është shumë e vogël që trajtohen vetëm në dy pika nën një.

Ne mendojmë se kjo duhet të zgjerohet edhe pika mendojmë prapë njëjtë sikur në logjikën e nenit 16 e ka një përjashtim të aplikueshmërisë të Ligjit për shërbimin civil.

Dhe vetëm mu ndërlihdh me këtë nuk e di sa është një numër, mirëpo Ministria e Administratës Publike është në proces të plotësim ndryshimit të Ligjit për shërbimin civil.

Besoj se Zyra që i ka bërë projektligjin dhe duhet të koordinohet se si duhet të jetë kjo çështje.

Unë besoj se nuk është e drejtë ose ma e futë edhe Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm edhe këto kategori të punonjësve atje si shërbyes civil, derisa në këtë ligj ata nuk janë shërbyes civil. Dhe çka del, pastaj kur miratohen këto dy ligje del që në praktikë kem dy ligje të cilat i kundërshtojnë njëra tjetrën. Vetëm si sugjerim që të jetë një koordinim se çka është shërbyesi ynë dhe çka është shërbyesi civil.

Perspektiva e jonë se na e shohim këtë është që. Shërbyes civil nuk duhet të jenë auditori i përgjithshëm, zëvendës-auditori i përgjithshëm, ... është shërbyes civil duhet të jenë drejtori i përgjithshëm edhe auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Po ashtu mendojmë se në nenin 17, lirisht mund të futet një parim që quhet një parim që quhet një parim i konfidencialitetit nëse nuk gjen shprehjen më lartë edhe nëpër nene të tjera. dhe ai mund të formulohet në këtë mënyrë.

Informacionet e grumbulluara gjatë procesit të auditimit në lidhje me lidhjen e subjektit auditor apo punonjësit e saj nuk mund të përdoren për ndonjë qëllim tjetër përveç përgatitjes së raportit, përveç rasteve kur parashihen ndryshe ..

Dhe pika e dytë e të njëjtit nen mbi parimet konfidencialitetit, auditorët duhet të mbajnë konfienciale çdo të dhënë të mbrojtur me ligj

e cila iu është bërë e ditur përveçse nëse e ... nuk mund tua bëjnë të ditur këtë informacion palëve të tjera. Në vazhdimësi neni 18, është vetëm çështje kompozim teknik besojmë se emri i neni 18 mospërputhshmëria, përmbajtja e neni flet për konfliktin e interesit pastër dhe kjo duhet të shndërrohet në konflikt të interesit si emër i neni 18, pastaj edhe një pikë apo dy të tjera është neni 22 lloji ... e përkufizimi neni 3 përmenden dy lloje të ... grupi i performancës së auditimeve ... ndërsa në pikat e neni 22, pika 1.1 dhe 1.2. duket se flitet për të njëjtën çështje, mirëpo që nuk përkufizohen saktë ashtu siç e përkufizon edhe neni ...

Mendojmë se këtu duhet të jetë një riformulim, çka është auditimi ... të definohet çka është auditimi i performancës të përkufizohet. Pastaj, një çështje tjetër që mendojmë se duhet të shtohet ... është që unë besoj që zyra kombëtare e auditimit e dinë edhe më mirë, por edhe nga komunikimet e mëhershme duket se ka pas një mekanizëm ndëshkues i cili pak a shumë kish me fuqizuar punën e auditorëve nëpër institucionet ... e kemi menduar që duhet të jetë një nen i veçantë ose pikë brenda ndonjë neni pikë ndëshkimi, për shembull për shkelje eventuale në kuptim të këtij ligji subjekti i audituar mund të ndëshkojë në vlerë monetare prej kaq-kaq pastaj ju mund ta .. aty.

Për shembull, nëse dështon të prezantojë para auditorit dokumentet përkatëse, si pasqyrat financiare apo çfarëdo dokumenti tjetër që ka të bëjë me auditimin dhe nëse prezanton ndonjë informacion të rrejshëm, dhe për të gjitha shkeljet lidhur me veprimet dhe mos veprimet nga paragrafi 1 i neni edhe përfaqësuesi ynë i ... dënohet me një vlerë prej që mund të vendoset më vonë.

Besojmë që pastaj edhe një çështje tjetër shumë teknike kur e sheh projektligjin në përgjithësi neni 2 dhe neni 4 flasin për një çështje që janë shumë të afërta njëra me tjetrën, organizimi i punonjësit besojmë se neni 3 duhet të largohet, po mendoj jo të largohet nga projektligji por neni 2 dhe neni 4 duhet të jetë afër njëri me tjetrin për shkak se trajtojnë një çështje pothuajse të njëjtë.

Për momentin nuk kam tjera komente, ... siç e përmendi edhe kolegu Dreni nga Grupi për Studime Juridike ne i kemi dërguar komentet dhe jemi të gatshëm në varësi të procedurave që përcakton komision nëse vjen puna që të krijojmë një grup punues apo diçka të afërt me profesionet që i kemi edhe aty do të mund të shkojmë në ... kompozimeve, pastaj varet nga ju se si i trajtoni ato. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe juve për këto komente. Para se të vazhdojmë me punën edhe një çështje rreth çështjes së masave ndëshkuese.

Komisioni për Mbikqyrje të Financave Publike ka rol të një ndërmjet që është trup e Kuvendit, që merr raportet nga auditori por merr edhe raporte tjera mund të bëjë edhe hulumtime të veçanta përveç ekspertëve të pavarur me qëllim që raporti që i drejtohet Kuvendit për miratim të jetë sa më komplet dhe t'i afrohet asaj çfarë ka ndodh. Nuk ka mekanizëm ekzekutiv edhe më tutje komisioni edhe Kuvendi e mbajnë përgjegjës Qeverinë për mos respektimin e punëve të njëjtin rol e ka edhe auditori.

Nuk është organ ekzekutiv, ai na drejtohet ne, ai mund t'ju drejtohet edhe prokurorisë në raste të veçanta nëse ai e vlerëson se ka hapësirë përtej, por ai nuk merr masa ndëshkuese. Ju lutem, ky është sistem i veçantë nga regjioni është stili anglo-sakson, dhe parimet atje është një postulat ku thotë, kur flet për standardet thotë merre ose leje. T'ju përkujtojmë se kemi pasur shumë debate, shumë sugjerime edhe ne kemi menduar kështu si ju në herën e parë të mandatimit të këtij projektligji në finale Zyra Evropiane del me një koment të vetin që i bind deputetët dhe nuk miratohet dhe është rezultat i asaj që dy vjet.

Prandaj, duhet t'i marrim sugjerimet ashtu siç janë nga Bashkësia Ndërkombëtare rreth kompetencave dhe mandatit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Urdhëroni, vazhdojmë diskutim. Urdhëro!

Enver Buqolli: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, unë jam Buqolli përfaqësuesi i sindikatës së zyrës së auditorit të përgjithshëm ... edhe ne kemi dhënë komentet tona për këtë projektligj,

Po mundohem të jem sa më i shkurt ... kohë po kaloj menjëherë te neni 1, do të thotë qëllimi i veprimtari dhe kompetencat e auditorit të përgjithshëm, si dhe themelimin të ... duhet të fshihen nuk kemi nevojë të promovojmë një institucion i cili është .. që 13 vite, kemi thënë shumë herë dhe duna me e përsërit prapë. Ne kemi nevojë .. institucionit me kompetencat që i kanë ... aktual dhe s'kemi nevojë të ndërtojmë një institucion të ri që tash duhet ... po bëjmë dy institucione apo mbyllet ai institucion apo çka po ndodh, përgjigjja është te neni i parafundit ku thotë me këtë ligj kështu që duhet ... çka nënkupton ajo... përfaqësuesin e Ministrisë së Financave, ... edhe të na jep një përgjigje këtu, a jeni duke i bërë dy institucione....

KRYETARI: Ju bëjeni komentin e juaj ne i marrim edhe të tuajin edhe të tyre. Ju kam dhënë hapësirë me qenë dëgjim publik, përndryshe sindikata duhet të merret me çështje sindikale nuk po dua të ua marr po këtu e keni edhe zyren juridike të zyrës kombëtare të auditimit, prandaj komentet ne nga ajo fushë më tepër i marrim nga ajo pjesë, por i marrim edhe të juajat nëse shohim arsyen dhe logjikën për ta inkuorporuar, për ata edhe jeni këtu.

Duhet të ju them në komente të shkurtra.

_____: te neni 4 paragrafi 5, ... duhet të thuhet... procedurat të përcaktohen në paragrafin 4 të këtij neni, prej dy paragrafëve vijues 5.1 dhe 5.2 ... komisioni parlamentar i mbikëqyr financat publike në raport prej 90 ditëve e parasheh para skalimit të mandatit të auditorit i dorëzon me shkrim ... rekomandimin për përshkrimin e mandatit të mundshëm të dy neneve.

Mendoj se këto mund të bien ndesh me Kushtetutën, sepse komisioni nuk mund t'i kërkoj Presidentes në këtë rast një propozim, por Presidentja vetë pas Kushtetutës e bën propozimin për Kuvend. ...

Te neni 4 pika e 6, ... në fushën e ... auditimit të financave publike për administratën publike, ... është një telashe shumë e madhe del përpjekjet për të zgjedh auditorin, ndoshta duhet me qenë një afat ... edhe do të thotë ... përvoja jo m pak se tetë vite ndoshta është më mirë ... siç ka qenë edhe vitin e kaluar edhe t'i shtohet ajo pjesa së paku pesë vite përvojë menaxhimit përvojë

profesionale mund të ketë shumëkush por menaxhuese s'po ka shumëkush. Edhe neve na vyn me na ardh një auditor i përgjithshëm që ka përvojë edhe në menaxhim dhe jo që nuk e ka përvojën e menaxhimit.

Te neni 4, kemi menduar të shtohet edhe një pikë atje te pika 4.6 dhe 6.3. për mua nuk ka qenë nën hetime, nuk ka qenë në një vepër penale nesër me menduar me shkru edhe nuk ka mbajtur poste politike dhe nuk ka qenë pjesë e atyre strukturave partiake në tri vjetët e fundit, kjo për me kriju një pavarësi nga efektet dhe ndikimeve të stafit politik.

Te neni 4, pika tjetër ,... në rast të skadimit të mandatit, ne kemi menduar se ajo duhet të fshihet që atë e rregulluar me nenin 10 po të këtij neni, në rast të skadimit të mandatit auditori ushtron funksionin e auditorit me ... deri në ardhjen e auditorit të ri. Unë po mendoj se ajo e kalon at afatin e paraparë kushtetues pesë vjeçar dhe ... auditori që merr mandatin për pesë vjet skadon ai mandat detyrat do t'i merr me automatizëm edhe thonë me një nen tjetër si ushtrues i detyrës vetë zëvendës auditori.

Neni prapë 4, pika 10, kemi menduar që duhet të shtohet në rast të dorëheqjes apo skadimit të mandatit. Këtu janë dhënë dy lloj zgjidhje për çështje të njëjta... dy situata në zgjidhjen e njëjtë sikur në rast të skadimit të mandatit, sikur në rast të dorëheqjes. Jo në njërin rast ndryshe në tjetrin rast ndryshe.

Te neni 4, pika 11.2 shprehje të pahijshme dhe të pasjellshme është ashtu e formuluar, ne kemi menduar ajo që duhet të zëvendësohet me një shprehje që të bie ndesh me kodin etik, se faktikisht gjithë stafi administrues e kanë për obligim me nënshkruar, respektuar kodin etik , por gjithashtu është nevojë edhe vetë auditori i përgjithshëm ta respektojë at kod etik jo me përdor shprehje e terma të paqarta...

Te neni 5, te themelimi i zyrës kombëtare të auditimit. Rrethanat e nenit të parë që është themelim kush mos të ekzistojë askund hiq në ligj se e dimë se zyra themeluese ... por ne kemi menduar ky nen të riformulohet dhe të shkruhet me tri pika të nenit, pika 1 e nenit 5, përmes këtij ligji Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorëve të Përgjithshëm të Kosovës ashtu e ka emrin sipas Ligjit 075 aktualisht është në fuqi, të zëvendësohet me emrin Zyra Kombëtare e Auditimit, domethënë t'i ndërrohet emri.

Neni 5.2 Zyra Kombëtare e Auditimit është trashëguuese e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për të gjitha pasuritë, stafin, buxhetin dhe detyrimet e saj kjo në një mënyrë po jetë e shkëputur kjo është përmend edhe në ligjet tjera kur ka ndodh, diçka ngjashëm është për shembull edhe për agjencionin e privatizimit kur ka ndërruar emrin prej Agjencisë Kosovare për Mirëbesim në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Gjithashtu, bordi për standarde ... kosovar tani që është Këshilli Kombëtar për Auditim Financiar domethënë është ... që të ne e propozojmë. Pika 3 e nenit 51 e kemi propozuar kemi thënë që Zyra Kombëtare e Auditimit thuhet që është institucioni suprem i auditimit në Kosovë. Të gjitha standardet ndërkombëtare e përdorin këtë term edhe e identifikojnë me këtë term. Fjala “themelim” kemi menduar që s' duhet të ekzistojë askund në ligj.

Te struktura e Zyrës Kombëtare të Auditimit neni 9, ne kemi menduar se duhet të riformulohet, do të thotë përmend kështu: Zyra Kombëtare e Auditimit përbëhet nga nën 1, auditori i përgjithshëm, një zëvendës auditor i përgjithshëm dhe jo më shumë se tre ndihmës auditorë të përgjithshëm, se aty është mbet e paqartë ose e papërcaktuar numri i ndihmës auditorëve që mund të zgjidhen.

Tre ndihmës të auditorëve, të cilët nuk janë shërbyes civil por na duhet të rregullohen me një përveç auditorit që u përmend me u përmend edhe mënyra e zgjedhjes të këtyre dy pozitive tjera, si e zëvendësit si e ndihmës auditorëve duhet të rregullohet me ligj. Çfarë kritere duhet të plotësojnë, kush mund të jenë ata, sa do të jetë mandati, cilat do të jenë detyrat e tyre, a mund të rizgjidhen e çështje të tjera, jo veç një pozitë ligjore pa e ditur çka është puna e tij, qysh zgjidhet, qysh hartohet...

KRYETARI: Ju lutem në pika të shkurtra se e kemi kohën e limituar.

____: Pika 2, e nenit 9 që ne kemi propozuar kemi thënë se tani zyra kombëtare përbëhet nga: drejtorët e departamenteve të auditimit, udhëheqësit e ... auditorët e lartë dhe auditorët. Dhe pika tjera vazhduese dhe stafi tjetër profesional në administratë dhe stafi mbështetës të cilët sipas mendimit të sindikatës komentet e kolegut parafolës se këto dy pika jemi deri diku afër. Po e përmendi aty pika te neni 13 pika, 3 në fund të fjalisë kemi menduar që duhet të ... edhe në organizatat tjera profesionale, sepse ka edhe atje zyra kombëtare dhe mund të bashkëpunojmë me gjykatën edhe ... supreme të auditimit të huaja dhe të përfaqësojnë Kosovën në po ne kemi edhe organizata tjera përveç institucionit kemi edhe organizata tjera ... që duhet të jemi anëtare të saj edhe të mos ua pamundësojmë me ligj mos me kon me pjesë të atyre organizatave.

Neni 15, pika 3 duhet të jetë atje kanë thënë që nga një faktor ... të jashtme dhe të pavarura dhe të pranuar ndërkombëtarisht që të kryejë auditime të detyrueshme të pasqyrave financiare të zyrës kombëtare. Ne kemi menduar se duhet të jetë Kuvendi të caktojë një firmë audituese të pavarur dhe ... në Kosovë që të kryejë auditime. ... se është e rregulluar me Ligjin 04/ L-014 neni 21 pika 5 për raportim, auditim edhe ... financiar kontabilitet dhe ... se si rregullohen dhe licencohen këto kompani audituese edhe në qoftë e huaja duhet të marrë licencë në Kosovë, jo me mbet si kompani që është e huaj por e palicencuar ajo nuk drejtë në baza fizike me vepruar në Kosovë realisht.

Neni 16, po e kaloj se ... te neni 19 pika 3 paragrafi 3. 2. Të korrigjohet ... kanë pranuar një buxhet të gjitha organizatat të cilat kanë pranuar një buxhet përmes ligjit vjetor të buxhetit janë të obliguar që të hartojnë pasqyra vjetore financiare. Ne kemi menduar që të kanë pranuar një buxhet dhe ... buxhet i papërcaktuar për të përmendet një term atje të bëhet që pranojnë ... organizatat buxhetore që të pranojnë një buxhet, qysh e kanë pranuar një buxhet ai një buxhet është...

Shtohet edhe një pikë tjetër në vazhdim ... të gjitha institucionet publike që vetëfinancohen për shembull BQK-ja, janë mbet të papërfshira edhe në këtë ligj edhe në ligjin e kaluar, ne e dimë që BQK-në s'e auditojmë, s'e auditojmë.

Te neni 25 edhe këtu vjen në shprehje që është e paqartë, drejtori i përgjithshëm i njofton organet kompetente të zbatimit të ligjit kur vëren tregues të shkeljeve të mëdha. Çka është kjo “shkelje e mëdha”? ne kemi menduar se duhet me e zëvendësu këtë me këtë shprehje “shkelje të mëdha”, me çdo shkelje që ka qenë element i veprës penale të sanksionuar me legjislacionin me fuqi. Të zëvendësohet kjo shprehje.

Pika ime e fundit, kjo është debat s’kemi

edhe... ku kemi ... puna e kolegut, duhet të jenë atje disa masa, nëse dikush provon të na bëjë ... fushëveprim, masa ndëshkuese. Ne prapë e ndajmë atë mendim. Ua dhashë shpjegimin, unë nuk po e zgjas më shumë për të, por ne prapë e mbajmë atë mendim, se duhet që ne të ballafaqohemi me mundësinë e kufizimeve në terren. Dhe, po qe se nuk do të jetë një dispozitë e tillë...

KRYETARI: Faleminderit!

_____ : ... të mos kufizohemi në terren.

KRYETARI: Unë nuk i dhashë komentet e mija. Unë interpretova atë që na e kanë thënë të tjerët dhe rezultat i asaj që ne e shqyrtojmë tash e jo para dy vjetësh ta kemi miratuar. Faleminderit!

Edhe, ku kemi ... puna e kolegut, duhet të jenë atje disa masa, nëse dikush provon të na bëjë ... fushëveprim, masa ndëshkuese. Ne prapë e ndajmë atë mendim. Ua dhashë shpjegimin, unë nuk po e zgjas më shumë për të, por ne prapë e mbajmë atë mendim, se duhet që ne të ballafaqohemi me mundësinë e kufizimeve në terren. Dhe, po qe se nuk do të jetë një dispozitë e tillë...

KRYETARI: Faleminderit!

_____ : ... të mos kufizohemi në terren.

KRYETARI: Unë nuk i dhashë komentet e mija. Unë interpretova atë që na e kanë thënë të tjerët dhe rezultat i asaj që ne e shqyrtojmë tash e jo para dy vjetësh ta kemi miratuar. Faleminderit!

Urdhëroni! Kanë qenë vërejtje të të tjerëve, që kanë ndikuar, edhe unë thash, kanë qenë standardet “merre ose lëre”. Urdhëroni, kush e do fjalën? Urdhëroni!

ARTAN CANHASI: Kryesues,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit për mundësinë që të shprehem. Unë jam Artan Canhasi nga Instituti Demokratik i Kosovës.

S’isha i përgatitur për takim, sepse morra vesh para gjysmë ore që do të mbahet. Kam pasur me kryetarin e Komisionit dhe kam qenë pjesë e grupit punues në këtë komision, po diçka kanë bërë këtu administrata improvizohen... më falni, nëse bëj ndonjë lëshim apo gjë të tillë.

KRYETARI: Administrata po më njofton që me vonesë ju kanë njoftuar. Kërkoj falje në emër të tyre. Urdhëro, vazhdo!

Artan Canhasi: Edhe unë po u kërkoj falje paraprakisht. Ne në KDI kemi analizuar punën e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe do të flas nga perspektiva e produkteve dhe rezultateve, të cilat i ka kjo zyrë.

Kemi analizuar punën e zyrës në vitin 2011, e kemi bërë edhe një vlerësim tjetër, që është po në vitin... në fund të vitit të kaluar, nuk e di a keni marrë ndonjë kopje, një punim që duket si ky, nëse jo unë po ua dërgoj, mirëpo gjendet në ueb sajtin e KDI-së.

Në këtë punim, janë nënvizuar 15 institucione të ndryshme, kapaciteti i tyre, qeverisja, si dhe roli që luajnë në luftën kundër korrupsionit në këtë drejtim, kështu që ... si menaxherë të korrupsionit, është të forcohet llogaridhënia, që është edhe fushëveprim i këtij komisioni.

Ajo çfarë kemi vërejtur, është se që nga viti 2010 është protestuar dhe janë dyfishuar resurset për Zyrën e Auditorit dhe cilësia e punës që e bën, është e jashtëzakonshme. Në fakt, këtë punim Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka dalë si organi që funksionon më së miri në Kosovë nga 15 të nënvizuarat. Diçka që duhet me u ndal, është stafi i Auditorit dhe vetë menaxhmenti, që nuk e ka lejuar faktikisht këtë duke u nisur edhe nga ky parim ne kemi parë pak të çuditshme, përse Ministria e Financave ka bërë një prioritet që të ndryshohet një ligj, i cili funksionon mirë në realitet.

Një institucion që funksionon mirë, ka rezultate shumë të mira, ka raporte shumë të mira dhe ndër hapat e parë të kësaj Qeverie ka qenë ndryshimi i Ligjit për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Nuk kam dyshim, se duhet parë hapësirë për përmirësimin, por pse është ky prioritet, pse nuk ka qenë, për shembull, prioritet Ligji për konflikte interesi, apo situata të ndryshme, është pak e çuditshme. Për atë arsye edhe ka qenë arsyetimi im, ndoshta që është përmendur edhe në komision, se përse kemi dalë kundër ndryshimit të këtij ligji. Nuk është se nuk duam ta shohim këtë ligj të ndryshuar e të përmirësuar, mirëpo ka pasur prioritete të ndryshme, më të fuqishme, shumë më të fuqishme dhe është marrë ky ligj. është marrë Ligji për qasje në dokumente publike, një ligj tjetër që funksionon mirë, por për këtë rezultat është pak absurde.

Që të jem më konkret, për propozimet tona, propozimi ynë i parë është: Mos e ndryshoni ligjin, mos humbni energji për diçka që është, është... funksionon mirë. Por, nëse s'kemi ardhur deri në këtë pikë, nëse ndryshohet ajo çfarë kemi vërejtur, është se një pikë që Auditori i Përgjithshëm mund ta bëjë më mirë, që lidhet ndoshta me, me... atë që foli edhe kryesuesi, është gjetja dhe sanksionimi i parregullsive. Zyra e Auditorit gjen shumë shkelje, sanksionimi i tyre faktikisht nuk bëhet. E kuptoj atë logjikën që komisioni, ky komision shërben si trup ndërlidhës ndoshta, mirëpo për fat të keq ky komision nuk është se ka mbajtur dikë përgjegjës, e ka shkarkuar ndonjë zyrtar të lartë të institucionit, që është bazuar në pasqyrat financiare, që janë audituara nga ZAP. Si rezultat i kësaj ne kemi kërkuar që të anashkalohet ndoshta ky komision dhe drejtpërdrejtë Zyra e Auditorit të bashkëpunojë më shumë me Prokurorinë edhe të sanksionohen këta keqbërës. Në shumë raporte shihet qartë, domethënë edhe ne që s'jemi ndoshta ekspertë të fushës, që ka shkelje të mëdha në këtë drejtim.

Për këtë arsye, ky ka qenë edhe rekomandimi ynë i parë, që nëse ndryshohet, në njëfarë forme, detyrohet me Ligj që ZAP-i t'i dërgojë këto raportet kur ka shkelje flagrante, faktikisht, jo të ngremë këta flamuj të kuq, por t'i dërgojmë menjëherë në Prokurori rastet.

Tjetra që kemi kërkuar, është që të rriten kapacitetet. Mirëpo, është diçka që nuk mund të rregullohet me këtë ligj dhe ajo që mund ndoshta, të rregullohet në këtë fazë dhe duhet bërë është procesi i emërimit të Auditorit të Përgjithshëm, sepse siç e ceka në fillim, ne po shohim rezultatet që prodhon kjo Zyrë e që prodhojnë këto situata, pasi s'kemi mundur ta zgjedhim për kaq shumë kohë, atëherë shihet që e kemi pasur gabim. Kështu që, ka hapësirë që të rregullohet kjo fushë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe juve për këto komente! Urdhëroni, kush e do fjalën? Artan, urdhëro!

_____: Faleminderit, kryetar!

Deputetë,

Do të thotë, nëse prej asaj që edhe e dëgjova dhe nëse shikojmë në përgjithësi diskutimi kryesor lidhur me këtë ligj, u ngritën shumë çështje, që nganjëherë mund të jenë procedurale, ose thjesht edhe përkufizime. Diskutimi kryesor këtu ishte tash, por ka qenë edhe në të kaluarën, ajo është se cila është pozita e auditorëve.

Do të thotë, shërbim civil apo jo shërbim civil, cili duhet të jetë niveli i pavarësisë dhe a është shërbimi civil kufizues për punën e auditorëve apo jo? Do të thotë, të dyja i kanë anët e medaljes, të mirat dhe të këqijat, mirëpo duhet shikuar se cila vërtet e ndihmon edhe e përkrah punën e Auditorit të Përgjithshëm që të mund të arrihet rezultati, jo vetëm këtë rezultat që e ka, por që është rrugë zhvillimore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm – ecja përpara.

Shumë prej komenteve që janë dhënë e janë adresuar edhe në të kaluarën, bashkë me Ministrinë e Financave me Zyrën Ligjore në Ministri të Financave, jemi ulur, i kemi adresuar dhe e kemi një memorandum shpjegues, ku janë adresuar. Ne do të jemi në përkrahje të komisionit për të gjitha këto pyetje, ta ofrojmë edhe pikë vështrimin tonë si hartues. Mirëpo, edhe ajo që ka dalë, arsyeja e kësaj ka qenë mu këto që i ngriti edhe KDI-ja në fund, se kemi vërejtur një numër të mangësive lidhur me funksionimin dhe kemi vërejtur një numër të pengesave lidhur me funksionimin e Zyrës së Auditorit dhe kjo ka qenë një, shërbimi civil auditorët brenda shërbimit civil dhe dy është struktura organizative, e cila duhet të mundësojë më shumë punën e auditorit në përkrahje të institucioneve publike.

Tash nuk do doja... unë po mbetem më shumë në dispozicion të komisionit, të anëtarëve të komisionit, për çfarëdo pyetje që kanë, për t'ia adresuar ose ligjit, ose atyre që u ngritën nga shoqëria civile dhe nga sindikata.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni!

Enis Spahiu: Nëse më lejohet të bëj sqarimin që u kërkuar nga zoti Enver Buqolli.

Besoj që edhe ju e keni shumë të qartë, që këtu është fjala për vetëm një institucion e jo dy. Ne e kemi përdorur termin “themelim” meqë shikuar nga ky këndvështrim juridik, me shfuqizimin e ligjit të vjetër shuhet një institucion e me hyrjen në fuqi të këtij ligji krijohet një institucion tjetër. De jure, shuhet një institucion por themelohet një institucion tjetër, ndoshta de facto sigurohet konsistenca.

Propozimi juaj, besoj që është shumë më i papërshtatshëm, nëse nuk ka trashëgimi në mes institucioneve publike, po që se e keni fjalën për trashëgimi, si çështje të javës. Esenca është të sigurohet konsistenca dhe termi që e kemi zgjedhur e që e kemi arsyetuar është shuarja e një institucioni dhe themelimi një institucioni të ri. Ky është këndvështrimi juridik.

KRYETARI: Faleminderit! Dëshiron dikush? Po vërej se nuk kemi komente tjera. Para se ta përmbysim këtë, ju lus... Urdhëro! Para se ta marrë fjalën, ua prezantoj, është koordinatori i Agjencive të Pavarura të Kuvendit të Kosovës.

Fehmi Pireva: Faleminderit!

Sa i përket projektligjit, ndoshta nuk e di sa është shumë vërejtje esenciale, por duke parë edhe strukturën e legjislacionit, ose kornizën dhe procedurat e përzgjedhjes edhe në institucionet tjera, po më duket te neni 4, në mos është dashur të specifikohet, se kandidati për auditor duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, nuk e pash që është në projektligj e specifikuar. Kjo në... unë nuk e gjeta... nëse... nuk është as në ligj, po as në këtë projektligj... mendoj se ka qenë mirë të specifikohet, se kandidati për auditor nuk ...

Ne po ballafaqohemi edhe me një kërkesë, ndoshta s’është specifikuar edhe gjatë punës, me raportet vjetore ose pasqyrat e subjekteve politike. Unë personalisht kam punuar nja 4 vjet në Zyrën për regjistrim të partive politike dhe kam pasur kontakte me zotin Lotson dhe që atëherë e kemi ngritur, që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pasur telashe dhe ka edhe sot rreth mbikëqyrjes së raporteve vjetore, pasqyrave dhe të hyrave që i krijojnë subjektet politike. Ndoshta, ka qenë mirë të mos nxitohet, të specifikohet një formë e mbikëqyrjes përmes auditorit, edhe pse arsyetimi i Lotsonit atëherë ka qenë, se mund të mbikëqyret pjesa e të hyrave, se ka që burojnë prej institucioneve fonde, por nuk mund t’i mbikëqyrim transaksionet që vijnë prej subjekteve afariste private. Ndoshta, në këtë mes ka mundur të gjendet diçka që të specifikohet dhe të vlerësohet procesi i mbikëqyrjes dhe të bëhet sa më transparente pasqyra financiare vjetore te subjektet politike.

Mendoj se edhe te propozimet e presidentes nuk është e specifikuar, sado që kemi kandidatë që i nënshtrohen procesit të konkurrimit, sa e di unë deri tash, ka shkuar praktika që presidentja ia ka ofruar vetëm një kandidat për votim Kuvendit. Nuk besoj se do të ishte shumë e qëlluar, se shumë herë kjo gjë ka krijuar telashe me përsëritje të konkursit dhe në zvarritje të procesit të emërimit të kryesuesit të Zyrës së Auditorit, që të shkohet me kandidatë pak më shumë dhe të gjendet forma, që ne ta kemi ... si kuvend në afatin kohor të jemi më ekonomikë në drejtim të përzgjedhjes së auditorit dhe të mos bëjmë procedura burokratike dhe të zvarrisim procesin e emërimit. Këto janë disa, kryesues, se nuk pata më shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sa i përket emërimit apo propozimit të presidentes, sigurisht se është shkuar në bazë të logjikës. Ne ishim në Skotlandë dhe atje vërejtëm, se auditorin e ka

përzgjedhur mbretëresha dhe ai është i përjetshëm. Do të thotë, ka shkuar sipas një logjike të asaj. Personalisht, mua më fle që të jenë dy kandidatë dhe të përzgjidhet njëri, por janë marrë disa modele, është të jemi në harmoni me standardet që aplikojnë këtë formë të auditimit në Botë.

Dikush tjetër, ndonjë koment tjetër? Po, ke të drejtë te përzgjedhja dhe procedurat e përzgjedhjes, ka qenë e udhës pak më ndryshe të bëhet, se komisioni është krejt jashtë procesit në procedurat e përzgjedhjes së drejtorit dhe në fund i kërkohet që ai ta bëjë arsyetimin në Kuvend. Duhet ta bëjë dikush tjetër, dikush që ka qenë në rrjedhë të procesit dhe mendojmë se përmes këtij drafti, jo të ndërhyjmë ne atje, por do të duhet si vëzhgues dikush të jetë nga komisioni, në mënyrë që ta ketë kontinuitetin e punës ose si ka rrjedhë procesi për ta interpretuar më vonë në Kuvend, sepse ne nuk i dimë procedurat, nuk i dimë as standardet të cilat i kanë përdorë, as rezultatet dhe, në fund fare, ne duhet të dalim e ta mbrojmë qatë propozim, s'mund ta mbrojmë pa elemente.

Prandaj po them, është një kombinim që mirë e ceke, po nuk guxojmë të dalim shumë jashtë standardeve që i përdorin të tjerët. E dëshiron edhe dikush fjalën? Po urdhëro, Ibrahim!

Ibrahim Gylderen: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje të gjithëve!

Vetëm ta konfirmoj atë që e tha edhe Artani, që çështja kryesore që është diskutuar dhe që duhet të diskutohet në ligj është pyetja nëse stafi auditues duhet të jetë në kuadër të shërbimit civil apo të dalë jashtë shërbimit civil, për arsye se kjo çështje ka ndikim më të madh në punën e auditorëve dhe në punën e Zyrës së Auditimit. Edhe çështjet tjera janë të rëndësishme, mirëpo më pak ndikim kanë në punë.

Domethënë, sikur çështjet tjera, vetëm ta falënderoj zotin Canhasi për fjalët e mira për Zyrën e Auditorit dhe për vlerësimin e mirë, po kemi bërë punë të mirë e nganjëherë edhe nuk kemi ditur të tregojmë, më shumë kemi bërë se sa që kemi ditur të tregojmë punën që kemi bërë, mirëpo nuk do të thotë, që nuk kemi pasur vështirësi. Vështirësia kryesore ka dalë prej ligjit ekzistues, për arsye se ligji është nxjerrë në vitin diku 2009, në kohën kur ne kemi kryer përgjysmë më pak auditime dhe kemi pasur përafërsisht përgjysmë më pak staf. Dhe, për këtë arsye duhet të përshtatet edhe ky ligj.

Ne si menaxhment kemi vërejtur se të tjerët, stafi në kuadër të shërbimit civil paraqet disa vështirësi, për arsye se është, auditorit janë shërbyes civilë, prej themelimit të zyrës gjithmonë kanë qenë në kuadër të shërbimit civilë, mirëpo në vazhdimësi kemi pasur disa telashe, disa vështirësi. Njëra prej tyre është që në njëfarë forme kjo ta japë mundësinë që zyra, menaxhmenti i zyrës të hyjnë në njëfarë diskutimi me MAP-in, me Ministrinë e Financave në tejkalimin e disa sfidave, të cilat dalin në kuadër të shërbimit civil. Kjo është vështirësia kryesore dhe rreziku kryesor, pse ne mendojmë që ndoshta më mirë është të dalin auditorë nga shërbimi civil, mirëpo siç tha Artani, të dyja kanë anë të mira dhe anë jo të mira. Duhet të mendohet edhe diskutimi kryesor të përqendrohet në këtë pyetje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe juve! Urdhëroni!

: Duke ditur rolin që e ka drejtori i përgjithshëm dhe me gjithë këto lëvdatat që vërtet i meriton për punën që e kemi bërë për punën e Shërbimit civil, do të thotë mund të gjendet një mes dhe ai mes mund të jetë që faktikisht punëtorët, do të thotë auditorët mos të jenë... mirëpo ligji i cili zbatohet mbi to të jetë shërbimi civil. Ky do të thotë praktikohet në disa vende, për shkak që me pas fatin për ta praktikuar edhe drejt në Kosovë, dhe besoni se Ligji i punës është shumë i mangët. Është shumë i mangët dhe punëtorët e ... shpejt prej punës dhe gjithkund arsyetohen shumë me ligjin dhe diçka e tillë nuk bën të ndodhë me auditorët e Republikës së Kosovës, kështu që do të ishte e udhës që pikërisht të ndodhë kjo, do të thotë përzgjedhja dhe këto tjerat të bëhen sipas Ligjit për shërbimin civil si dhe largimin e masave disiplinore mirëpo ata të mos jenë shërbyesit civilë, kështu që do të gjendet një mes, të largohen konfliktet në Ministrinë e Administratës Publike dhe prapë shërbyesit ose më mirë me thënë edhe auditorët e kanë një mbrojtje shumë më të lartë se sa që do ta kenë punëtorët e thjeshtë në Kosovë.

KRYETARI: A ka kush ndonjë koment?

Dren Ajeti: Faleminderit kryetar! Do të thotë, vetëm për të adresuar shkurtimisht diçka që ju e ngritët edhe më herët, që është se bazohen në parimet e Ligjit për shërbim civil.

Pra, ato që i emërove ti, janë parimet dhe tash është çështja a me e marrë për ta lexuar Ligjin për shërbim civil apo me filluar me i cek parimet aty. Mirëpo, qëllimi është që mbrojtja të jetë apo menaxhimi a është bazuar në atë, por me e pas pavarësinë e menaxhimit dhe zyra jo të jetë e diktuar nga jashtë, nga MAT-i, që do të thotë se ka shumë kufizime sa i përket ndarjes së detyrave, sa i përket mënyrës se si ne mendojmë që zyra duhet të ecë përpara. Do të thotë ato kufizime në fund, shumë thjeshtë, mund të kenë ndikim të madh në raporte të cilat ne duhet t'ia dorëzojmë Komisionit për mbikëqyrje të financave publike apo Kuvendit.

E ngritët ju edhe çështjen e ndëshkimeve dhe në këtë rast, pajtimin kryesor, e kisha pasur në atë që e përmendi edhe vetë kryesuesi i këtij komisioni, në këtë rast, zoti Ali Sadriu dhe diskutimet që kanë qenë me anëtarët tjerë të Komisionit.

Ne nuk besojmë se ndëshkimet financiare janë ato kryesore. Çka është kryesorja, është se ne si institucion në rast të mospërmbushjes së një kërkesë në terren, e kemi një mundësi për të cilën ne mund të ankohe mi. Dhe, nëse e marrim edhe rastin e sistemit anglosakson, Komisioni për mbikëqyrje të financave është Komisioni i cili, në rast se kemi cenim të çfarëdo të drejte për qasje, është Komisioni i cili përfaqëson Kuvendin dhe kur në rast se na cenohet e drejta për qasje, mundemi ne ta ngrisim si problem.

Pra, deri sa mendojmë që përmes një gjobe financiare mund t'i ikë një obligimi, atëherë për ne ajo është më shumë që shkon në anën negative se sa një përgjegjësi publike para Kuvendit për atë që të kryejë obligimin e vet ndaj shtetit, ndaj institucionit tonë, ndaj Kuvendit.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni!

_____: Faleminderit kryesues! Edhe më herët u përmend, po edhe tash po e them se më së miri problematikën e njohin ata që punojnë me ta. Ne mund të kemi një perspektivë tjetër.

Vetëm një shembull ta them lidhur me atë që u përmend. Arsyeja kryesore mund të mos jetë e njëjtë, absolut. Arsyeja kryesore pse sot plotësohet e ndryshohet Ligji për qasjen në dokumentin, është pikërisht për të gjetur një strukturë e cila kishte me pasur fuqi ekzekutive dhe pikërisht me i ndryshuar institucionet që nuk përgjigjen karshi atij kërkuesi për të drejtën e qasjes në dokumente publike...

KRYETARI: As ne e as ata s'e kanë atë mandat!

_____: Për shembull, edhe në Kosovë është duke shkuar pak shumë të futet një model pak a shumë slloven, që në Slloveni ekziston njëfarë komisionari për informim që në bazë të ligjit e ka të drejtën të ndëshkojë një institucion i cili nuk përgjigjet në të drejtën për qasje në dokumentet publike karshi një personi tjetër. Do të thotë, nuk çon peshë te ne, se ne kemi bërë shumë edhe me rekomandimet e Avokatit të Popullit, edhe me rekomandimet tjera, e tjera, që nuk merren shumë parasysh dhe po besoj që edhe këta të qasjes në dokument publike kanë komisionin për administratë publike, qeverisje lokale dhe mediat, i adresohen edhe atyre, u adresohen edhe strukturave tjera mirëpo prapë ato rekomandime, do të thotë, mbesin të mangëta. Shkojnë edhe me rekomandime te zyra e Avokatit të popullit, mund të shkojnë edhe në gjykata, mirëpo çështja e zbatimit të tyre, pastaj, mbetet e mangët.

Unë desha të them këtë, për shkak të një performance më të mirë, për shkak të një përgjigje më të mirë në kërkesat tuaja dhe nëse nuk përgjigjeni në kërkesat e juaja, ju do ta keni një mekanizëm më të fortë, më ekzekutues, me përjashtim të asaj që ju rekomandoni se i drejtoheni një komisioni apo diçka tjetër.

Mirëpo, po kthehem në fillim, se ju e dini shumë më mirë se si rregullohet kjo çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Shikoni! Nuk mund të themi të gjithë se nuk kemi asnjë element të ekzekutivit. Është pjesë e dëgjimit publik dhe në rrethana të tilla të dëgjimit publik, kur ministri ulet, mos të them në bankën e akuzuar, por në bankën e analizës dhe të performances së tij, sepse ka edhe analiza të performancave edhe pozitive, nuk është e lehtë kur t'i thuhet krejt ato që kanë ndodhur.

Problemi është që nuk po funksionon prokuroria në nivelin e duhur. Përndryshe, çështjet hedhen në sipërfaqe dhe çdo veprim yni apo edhe i këtyre, i këtyre edhe më hiq, do të tejkalon kompetencën dhe e humb logjikën. Këta do të duhej të jenë të nivelit vlerësues, të një niveli hulumtues për ta prezantuar gjendjen faktike të cilën e kanë ndesh.

Institucione tjera janë ato që duhet pastaj të merren. Ne bëjmë rekomandime, i afatizojmë për t'i kthyer në plan veprime. Kemi raste, dhe shumë bile, që i kanë kthyer planet e veprimet dhe përmes planeve të veprimit ne kemi vërejtur progres të theksuar, që ka ndryshuar një orientim. Por kemi të atillë që s'janë përgjigjur fare ose janë përgjigjur në stilin e vet.

Këtu ka qenë pra edhe një defekt sa i përket Ligjit të kompanive publike, sepse në raste kur Kuvendi nuk e miraton raportin vjetor të një kompanie, tani po mendojmë që ta sanksionojmë dhe domosdoshmërisht ai bord duhet të ndërrohet dhe të bëhet një analizë më e thellë.

Deri tash nuk ka qenë. Ne kemi raste që dy herë raportet vjetore iu kanë hedhur poshtë, nuk i janë miratuar dhe atyre s'iu kanë munguar një qime e flokut, përkundrazi janë rizgjedhur.

Prandaj, kjo i ka lindur ato. Dhe po të funksiononte, sigurisht se s'do të vinte deri aty. A do kush fjalën për ndonjë koment tjetër?

Nëse nuk ka, unë ju kisha thënë se kemi shumë komente tuaja të vlefshme dhe ju falënderoj për to. Ne do t'i marrim dhe analizojmë në detale gjatë punës së Komisionit. Nuk është e tepërt nëse mendoni t'i plotësoni ato rekomandime dhe përsëri të na i dërgoni, se ne pretendojmë në një periudhë shumë të afërt sepse jemi në kalim të afatit dhe këtu janë rrethanat se qysh punon Kuvendi dhe kjo është shtyrë. Kjo është dashur të përfundojë deri në shkurt, por ne do ta shfrytëzojmë të drejtën e Rregullores dhe do të kërkojmë afatin edhe për një muaj, kështu që Komisioni do t'i marrë të gjitha këto komente.

Unë desha të them edhe këtë se ata që nuk kanë bërë komente dhe mendojnë se kanë arsye të bëjnë të reja, përveç këtyre këtu që i ngritëm, na i bëni shtesë si rekomandime në mënyrë që ne gjatë përpunimit, nen për nen, t'i marrim ato komente.

Ne do ta shqyrtojmë versionin që e ka dhënë draftuesi, në këtë rast Ministria e Financave me pjesëmarrjen e përfaqësuesit aty dhe do t'i marrim edhe komentet e çdonjërit që flet për atë nen, dhe analizojmë për të gjetur një mundësi më të mirë.

Mirëpo, ju thashë, unë e kam praktikën e asaj që nuk guxojmë shumë të largohemi nga standardet ndërkombëtare, sepse në moment të caktuar ai del në Kuvend dhe duke u miratuar thotë: kjo është në kundërshtim me këtë e atë, e deputetët nuk e votojmë.

Dhe çka bëme? E shtyrëm edhe për dy vjet! Një gjë të tillë pra duhet ta mundohemi ta përpunojmë në detale, ta përafrojmë dhe zgjedhim diçka që është funksionale për ne, por që nuk është në kundërshtim edhe me dispozitat tjera.

Edhe një herë, ju faleminderit të gjithëve dhe ju mirëpresim për komentet tuaja. Anëtarët e Komisionit le të rrinë, ju tjerët jeni të lirë.